

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Në fakt, sot duhet të ishte një nga ditët më të rëndësishme, siç ishte ajo e dy javë më parë, sepse kemi miratimin e buxhetit të shtetit, por kjo qeveri, në mënyrë të qëllimshme, hileqare, solli projektin më korruptiv, për të hequr vëmendjen nga skandali. Në fakt, e quajmë skandal, duke përdorur edhe këtë moment, por duke marrë në konsideratë edhe PPP-të e famshme, edhe koncesionet, edhe investimet strategjike, që nuk ishin të pakta, por më shumë se 55, ku vetëm 2-3 maksimumi katër prej tyre janë strategjike, të tjerat janë korruptive, sepse janë dhënë miliona metra katrorë, janë falur miliardë lekë, që, në fakt, kanë shkuar te soji i rilindjes, jo për zhvillimin strategjik të Shqipërisë. Kur shohim këtë projekt me 2,1 miliardë, ne na bën që jo vetëm të jemi skeptikë, por të mendojmë se kjo do të jetë afërsisht korruptive më e madhe që ka njohur ndonjëherë Shqipëria.

Në fillim të vitit 2022 me të madhe paraqitët se do të vinte “Emar”, një kompani që ka ndërtuar Dubain, që do të punësonte rreth 50 mijë vetë, por, në fakt, sot jemi katandisur te 10 mijë të punësuar, 5 herë më pak; kjo kompani do të investonte jo pak, por 5 miliardë, që, në fakt, sot e kemi reduktuar në 2,1 miliardë; do të fillonte ndërtimi i “Marinës”, në fakt ju sot deklaroni se “Marina” do të ndërtohet pas 7 vjetëve; keni deklaruar se kompania ndërtuese do të ishte “Emar”, por sot del që është “Eagle Hills” me vetëm 10 mijë lekë kapital fillestar ose 82 euro, e cila merr përsipër 67% të 2,1 miliardë eurove. Kjo është korruptive dhe e papranueshme.

Unë dhe çdo qytetar shqiptar ngremë pyetjen: pse ky projekt strategjik zhvillohet pa garë?! Pse nuk pati terma kontrate? Pse nuk pati marrëveshje tjetër? Pse nuk ka një kosto çmontimi apo montimi të portit të ri të Durrësit? Këto janë argumente, të cilat duhet t’i kishte çdo qytetar, por edhe deputetët në parlament dhe nuk duhet të kalonte me procedurë të përshpejtuar. Po të shohësh, për “Marina Durrës” investitori strategjik do t’i paguajë shtetit shqiptar vetëm 2% të xhiros, ndërkohë nuk mjaftohet vetëm me 2%, por thotë se nëse xhiroja është me lartë se aq, do t’i jepet me tavan, do t’i jepen vetëm 200 mijë euro. Në fakt, 200 mijë euro janë sa një darkë te Nusreti. Kjo është e papranueshme. Porti i jahteve nuk

do të japë më shumë se 200 mijë euro në një vit. Kjo është skandaloze! Si mundet që ne jo vetëm ta bëjmë pa prokurim, por të mos kemi edhe një kompani konsulence të huaj?

Ne kemi pësuar nga mungesa e konsulencës së huaj. A ju kujtohet kur Kryeministri mbylli një televizion për kapriçot e tij? Avokatura e Shtetit, me anë të konsulentëve të saj, i tha mbylle, sepse ne nuk paguajmë asnjë lek, por, në fakt, paguam 109 milionë euro principal, po paguajmë interesa edhe sot, ku shtetit shqiptar i mungojnë 140 milionë euro. Jam i sigurt që nga kjo kontratë, që nuk ka ekspertizë ndërkombëtare, ne do të humbim pafundësisht, do të humbim nga pronarët, të cilët nuk vlerësohen; do të humbim nga kompani, që kanë investuar miliona euro, që, në fakt, do ta penalizojnë shtetin shqiptar; po humbim edhe sot, humbëm 28 milionë euro. Nga kush i humbëm? I humbëm nga partneri më i rëndësishëm i Shqipërisë. Kjo është e keqja, këto janë pikëpyetjet, të cilat ne na bëjnë të dyshojmë. I jepen 82 hektarë një kompanie, që nuk ka asnjë emër.

Nuk e kuptoj sesi mund të jepen kaq hektarë tokë për të ndërtuar një qytet. Këtë qytet disa ekspertë e krahasojnë me Singaporin, pra ky do të konkurrojë Singaporin, Manhatanin, pse jo edhe Dubain, sepse do të ndërtohen 1 milion e 350 metra katrorë dhe në këmbim të kësaj do të marrim vetëm 28 milionë dividend. Dividenti merret kur kompania mbaron investimin dhe fillon fitimi. Pra, edhe nëse do të merret ky dividend, do të merret pas 20-30 apo 40 vjetësh. Kjo është papranueshme, është skandaloze. Pse shteti shqiptar nuk përdori një ekspertizë ndërkombëtare? Pse nuk përdori të paktën e ekspertët e kompanive që ndërtojnë sot në Tiranë? Një kompani që ndërton sot në Tiranë, në Durrës apo kudo bie në marrëveshje me pronarin e tokës.

Ne kemi lënë jo pak, por 830 e ca mijë metra katrorë tokë, që do të konvertohen me 1 milionë e 350 mijë. Pse nuk marrim referencën e Tiranës? Një ndërtues shkon te pronarët dhe i atij në këmbim i kërkon 40% të sipërfaqes, më pas shkon te Bashkia e Tiranës dhe do të paguajë 1% taksë për shqyrtimin e dosjes, madje do të paguajë edhe 8% taksë infrastrukture, sipas referencës së çmimit të shitjes, shkuan 9%, po ashtu do të paguajë edhe 3% të tjera, që kanë të bëjnë me banesat sociale, ja ku shkoi në 12%, plus 40% që është mesatarja në Tiranë, gjithsej shkon 52%. Të mos harrojmë se mesatarja në Durrës është më e shtrenjtë sesa këtu. A ka ekonomist që mund ta vlerësojë ndryshe, në milionë e 350 pse ne nuk morëm 52%, që të përfitonim 750 mijë metra katrorë objekte, nëse nuk merrnin 750, të merrnim 700 metra katrorë.

Nëse ne e llogaritim vetëm me 1 mijë euro metrën katror, ne do të kishim fituar dy herë më shumë sesa dividendi; nëse do ta shisnim me dy euro, ne do të kishim marrë jo pak por 1,4 miliardë, 5 herë më

shumë sesa dividenti; nëse shitet me 4 mijë euro, që jam i sigurt se kaq do të jetë çmimi dysHEME, sepse aq po shitet edhe sot, ne do të kishim marrë 10 herë më shumë sesa dividenti. Kjo është një aferë e pastër korruptive, është e papranueshme. Unë jam i sigurt që kjo nuk duhet të kalojë, madje barriera kryesore e saj do të jetë Gjykata Kushtetuese, e cila do ta hedhë poshtë këtë aferë korruptive, dhe për këtë jam i sigurt. Pse e çlirojmë ne këtë projekt nga taksat?! Kjo është e pranueshme!

Një biznesmen shqiptar paguan jo vetëm taksat, por edhe ato përqindje që përmenda pak më parë. Pse duhet ta çlirojmë nga taksat, kur aty po ndërtohet një qytet?! Kush e garanton rrjedhën e parave, apo do të vijnë cubat ose çunat e Dubait dhe do ta ndërtojnë, sepse kompania ka vendosur në dispozicion vetëm 160 milionë euro, nga të cilat vetëm 80 milionë janë të sajat, nëse i ka, sepse ajo ka një kapital fillestar 82 milionë euro, ndërsa 80 milionë eurot e tjera do t'i marrë kredi?! Nuk është vetëm kjo. Ai ka mundësi ta fillojë investimin duke pasur disa para për shkak të pagesave, sepse sot, ende pa u miratuar projekti, janë hapur pikat e shitjes.

Ky është një skandal, të cilin ne nuk duhet ta pranojmë. Prandaj pyetjet e mia dhe të gjithsecilit janë: sa është kostoja e çmontimit? Sa është kostoja e transportit? Sa është kostoja e ndërtimit të një porti të ri? A është bërë fizibiliteti? Në këndvështrimin tim, kudo që kam parë porte, ato kanë qenë nëpër gjire. Atje ku do të shkojë porti, nuk është gji, por ka një thellësi më të pakët, që do të thotë se do të kushtojë edhe më shumë, atje ka erëra, që është rrezik real për portin dhe do t'i kushtojë buxhetit të shtetit. Ju nuk i keni bërë këto llogari dhe kjo është shumë e dhimbshme, aq më tepër kur hiqet një port historik. Porta hyrëse e Rrugës Egnatia ndoshta është e qëllimshme, por sa do të kushtojë infrastruktura rrugore, hekurudhore apo të tjerat që nevojiten për ta devijuar këtë aks shumë të rëndësishëm?

A i keni bërë përlogaritjet se sa humbje do të na shkaktojë për shkak të tranzicionit, sepse tregu do të orientohet në vende të tjera, në porte të tjera? Këto janë pyetje, të cilat duhet t'i ngrejë secili prej jush, për të cilat nuk ka një të vërtetë. Për të vazhduar më tej, sepse ka edhe mjaft probleme të tjera, të cilat janë shqetësuese për secilin prej nesh, por do të doja që të trajtoheshin dhe të shikoheshin me gjakftohtësi dhe jo me urdhër të shefit: "Duhet të kalojë, se them unë dhe pa bërë asnjë lloj analize!". Kjo është e papranueshme! Fatura e gjobave dhe e penalteteve do të jetë e jashtëzakonshme dhe ju keni për të qenë dëshmitarë të kësaj situate. E shisni si një investitor strategjik. Pse nuk zgjodhët një investitor tjetër? Pse zgjodhët këtë investitor?

Më kujtohet që më 22 qershor të këtij viti, fiks në kulmin e luftës Ukrainë-Rusi, ky shkonte dhe bënte foto me aleaten e saj më të madhe, me Bjellorusinë. Kjo do të thotë se këtu nuk do të vijnë vetëm rublat

bjelloruse, por edhe ruse, madje këtu do të na vijjnë edhe dinarët e Serbisë, sepse po vazhdon projekti, pavarësisht se ka dështuar. Pse nuk operuam edhe ne si Kroacia? Prandaj, them se fotoja e asaj date, e datës 22 qershor, në kulmin e luftës, është një tjetër sinjal për të mos sjellë rublat ruse, bjelloruse dhe dinarët serbë në Shqipëri. Faleminderit!